



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:023762

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05629960

KE.nr.48/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësve: 1) Sh.K., aksionar me 25% të aksioneve në "PharmaPlus" SH.P.K. me NUI: 810535429, 2) N.O., aksionare me 8% të aksioneve në "PharmaPlus" SH.P.K. me NUI: 810535429 dhe 3) I.Sh., aksionar me 42% të aksioneve në "PharmaPlus" SH.P.K. me NUI: 810535429, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Kërveshi & Partners", me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B.N., aksionar me 25% të aksioneve në "PharmaPlus" SH.P.K. me NUI: 810535429, me adresë në Lagjen Kalabria, Zona A1, H-B 14, në Prishtinë, me objekt kontesti Vlerësimi i kontributit në Shoqërinë "PharmaPlus" SH.P.K. dhe Përrjashtimi i aksionarit, jashtë seancës më datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësve: 1) Sh.K., 2) N.O. dhe 3) I.Sh. – Aksionarë në Shoqërinë "PharmaPlus" SH.P.K., me numër KE.nr.48/24 (2024:023762) e datës 22.01.2024, me objekt kontesti vlerësimi i kontributit në Shoqërinë "PharmaPlus" SH.P.K., dhe përrjashtimi i aksionarit, kundër të paditurit B.N..
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësit 1) Sh.K., 2) N.O. dhe 3) I.Sh., përmes të autorizuarit të tyre, më datë 22.01.2024 kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, kundër të paditurit B.N., me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve, të vërtetohet se

paditësit sipas investimit fillestar dhe kontributit janë aksionarë në Shoqërinë “PharmaPlus” SH.P.K. sipas përqindjes e cila do të përcaktohet me ekspertizë, të obligohen paditësit që në bazë të vlerësimit të vlerës së drejtë të interesit pronësor t’i paguaj të paditurit shumën e përcaktuar si në ekspertizë në emër të përjashtimit nga shoqëria, të obligohet i padituri që paditësve t’iu kompensoj dëmin material të shkaktuar sipas lartësisë që do të përcaktohet sipas ekspertizës financiare, si dhe të obligohet Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të bëjë regjistrimin e aksioneve sipas precizimit që do të bëhet pas ekspertizës si dhe të obligohet i padituri që të kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Me datë 04.04.2024, përfaqësuesi i paditësve me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar më datën 22.01.2024 dhe ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim me të cilin e konstaton të tërhequr padinë e paditësve.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së përfaqësuesit të paditësve, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.48/24, datë 26.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.